



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.92, datë 09.03.2022

PËR

VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATJA ZNJ. {...} TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË GJYKATËN E LARTË, PËR NJË POZICION TË LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS ADMINISTRATIVE DHE PËR DY POZICIONE TË LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 535, NR.536 DHE NR.537, DATË 17.11.2021, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE TË KANDIDIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 09.03.2022, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr.535, datë 17.11.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative...”

2. Me Vendimin nr.536, datë 17.11.2021, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

3. Me Vendimin nr.537, datë 17.11.2021, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

4. Në të trija rastet, afati i kandidimit është përcaktuar *“një muaj nga dita e publikimit i vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.*

5. Vendimet e Këshillit si më lart janë publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 17.11.2021, duke filluar të ecin afatet e kandidimit nga dita e nesërme, pra nga data 18.11.2021.

6. Brenda afatit të kandidimit, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me Vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 dhe për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me Vendimet nr. 536 dhe nr.537 datë 17.11.2021, ka kandiduar edhe gjyqtarja znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja), aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

7. Me Vendimin nr. 26, datë 17.01.2022, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimet e datës 17.11.2021, Këshilli ka vendosur:

“I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me nr.535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:31.Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro;...”.

8. Më datë 17.01.2022, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

9. Brenda afatit të përcaktuar, kandidatja nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

10. Më datë 24.01.2022, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidates iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

11. Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa një nga dokumentet, pikërisht formularin e deklaratës së pasurisë, sipas Vendimit 75/2019, kandidatja duhet ta dorëzonte, jo më vonë se 31 ditë nga dita e dërgimit të tij, pra deri më datë 24.02.2022, pranë ILDKPKI-së.

12. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 10.02.2022, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Lartë, ndër ta edhe për kandidaten znj. {...}. Për këto kritere ligjore kandidimi procedura e verifikimit është në proces e sipër.

13. Sipas pikës 9, Vendimeve të Këshillit nr.535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr.535, datë 17.11.2021, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë përcaktohen ..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës administrative, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*. Ndërsa në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë përcaktohen ..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës civile, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*. Nga ana tjetër, në shkronja “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtyre tre vendimeve, përcaktohet se: *“c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

14. Në respektim të vendimit si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kriterëve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidaten z. {...} u kërkuar dhe u administruar informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtares.

14.1 Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me Shkresën nr. 264/1 prot., datë 21.01.2022, përcolli informacionin dhe

dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

14.2 Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht nën kriterit të “përvojës specifike profesionale” të kandidates në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës administrative si dhe në fushën e të drejtës civile referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtares, konkretisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa është e qartë përvoja e kandidates në fushën e të drejtës administrative në Gjykatën e Apelit Administrativ. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë informacioni i kërkuar është përcjell me Shkresën nr. 701/1 prot., datë 02.02.2022 dhe më shkresën nr. 701/2 prot., datë 07.02.2022 , gjithashtu nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës informacioni i kërkuar është përcjell me Shkresën nr. 331 prot., 02.02.2022 siç do të përshkruhet më poshtë.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR TRE KRITERET E KANDIDIMIT

15. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

16. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr.535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, është parashikuar si kusht kandidimi në nenin 136, pika 3 (fjalë e parë), të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se: *“Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit”*. Ndërkohë, “përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë parashikohet dhe në nenin neni 47, pika 5, të Ligjit për Statusin. Sipas kësaj dispozite, ky kriter kandidimi përbëhet në vetvete nga dy të tillë, ai për “përvojën e përgjithshme profesionale minimale” dhe ai për “përvojën specifike profesionale minimale”. Konkretisht në këtë dispozitë të ligjit përcaktohet se: *“Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë Gjykatës së Lartë ..., nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*.

17. Për verifikimin e kandidates në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë u mbajt parasysh se ajo ka kandiduar për tre pozicione të lira, ato në fushën e të drejtës administrative dhe atë të së drejtës civile, çka do të thotë se kandidatja, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, që është e njëjtë për të tre kandidimet (në dy fushat e së drejtës), pra jo më pak se trembëdhjetë vjet, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, konkretisht në fushën e të drejtës administrative për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 535 datë 17.11.2021 dhe në fushën e të drejtës civile për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021.

18. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar studimet në degën Drejtësi në vitin 1994, në periudhën mars 1995 është emëruar ndihmësgjyqtar efektiv pranë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku ka ushtruar funksionin deri në maj 2000, kohë kur është emëruar si gjyqtare pranë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, ku ka ushtruar funksionin deri në prill 2010, kohë kur transferohet pranë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në periudhën mars 2016 është emëruar si gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit, ku vijon të ushtrojë funksionin e gjyqtares.

19. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...}, me vendim nr. 1, datë 30.03.1995 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet Ndihmësgjyqtar efektiv në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekret nr. 2626, datë 13.05.2000 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Me vendim nr. 260, datë 01.04.2010 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë transferohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekret nr. 9461, datë 15.03.2016 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Me procesverbal datë 09.07.2021 zgjidhet Zëvendëskryetare e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, funksion të cilin mban edhe aktualisht. Vjetërsia në funksionin e magjistratit është 26 (njëzet e gjashtë) vite dhe nuk ka masa disiplinore në fuqi.

20. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr.535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, ka mbi pesëmbëdhjetë vjet përvojë të përgjithshme profesionale, si gjyqtare në gjykatën e shkallës së parë dhe apelit, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës profesionale minimale”.

21. Në lidhje me përvojën specifike profesionale, në kërkesat për shprehje interesi të kandidates, evidentohet se plotëson kriteret profesionale, pasi ka gjykuar dhe punuar në fushën e të drejtës administrative dhe civile.

22. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se:

“Në përgjigje të shkresës suaj me Nr.600/1 datë 28.01.2022, protokolluar me tonën Nr. 701 Prot., datë 01.02.2022 në kuadër të ushtrimit të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor që lidhen me zhvillimin e karrierës gjyqësore (neni 147/a, pika 1, germa "a" i Kushtetutës) është duke u zhvilluar procedura për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, dhe referuar vendimit Nr. 26, datë 17.01.2022 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin Nr. 535, Nr.536 dhe Nr.537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në

Gjykatën e Lartë, për kandidaten znj. {...}. Lidhur me kërkesën tuaj po ju vëmë në dispozicion informacionin si më poshtë vijon ;

1. Urdhërin Nr.232 datë 21.11.2011 “Mbi Organizimin në Dhoma dhe Seksione të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë”.

2. Urdhërin Nr.9 datë 21.01.2013, me Nr.674 Prot date 21.01.2013 "Mbi Organizimin në Dhoma dhe Seksione të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë“.

3. Urdhërin Nr.39 datë 03.03.2015, me Nr.2998 Prot date 03.03.2015 “Mbi Organizimin në Dhoma dhe Seksione të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë”

- Çështjet e gjykuara nga ana e kandidates Gjyqtares znj. {...} gjatë periudhës që ka ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas verifikimeve të nxjerra nga sistemi i gjykatës për periudhën 01.01.2010 deri në 31.12.2017 referuar kërkesës, janë gjykuar gjithsej 2839 çështje, nga të cilat 2 çështje penale, 1355 çështje civile të përgjithshme, 2 çështje tregtare, 4 kërkesa penale, 389 masa sigurimi dhe 1087 kërkesa civile (bashkëlidhur statistikat).*
- Çështjet e gjykuara nga ana e kandidates Gjyqtares znj. {...} gjatë periudhës që ka ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas verifikimeve të nxjerra nga sistemi i gjykatës për periudhën 01.04.2010 deri në 15.03.2016 referuar kërkesës, janë gjykuar gjithsej 2839 çështje, nga të cilat 2 çështje penale, 1355 çështje civile të përgjithshme, 2 çështje tregtare, 4 kërkesa penale, 389 masa sigurimi dhe 1087 kërkesa civile (bashkëlidhur statistikat).*

23. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, rezulton se:

Në përgjigje të e-mail tuaj të datës 28.01.2022, si dhe shkresës nr.600 prot., datë 28.01.2022, të protokolluar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me nr.303 prot., datë 01.02.2022, në kuadër të procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtare pranë Gjykatës së Lartë për kandidaten znj. {...}, me anë të së cilës kërkoni evidenca mbi përvojën profesionale specifike si gjyqtar në fushën e të drejtës civile duke iu vënë në dispozicion edhe dokumentet provues përkatës (si p.sh. urdhra të Kryetarit të Gjykatës për ndarjen në dhoma/seksione të gjyqtarëve etj.), e cila përkon me fillimin e detyrës në vitin 2000 (vit i referuar sipas shkresës tuaj), ku është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, sqarojmë si më poshtë: Së pari ju bëjmë me dije se verifikimet e evidencave për përvojën profesionale të gjyqtares {...}, janë kryer në Sistemin CCMIS (Sistemi informatikë i menaxhimit të çështjeve gjyqësore - i cili krijon mundësi kërkimi për të gjitha çështjet gjyqësore të regjistruara pranë kësaj gjykate nga periudha 2007 e në vijim), nga Zyra e Financës si dhe nga Zyra e Arkivës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës sipas Volumeve të Vendimeve të kësaj periudhe (referuar periudhës së cituar nga ana juaj, viti 2000). Sipas konstatimit në Librin e Personelit si dhe në Librin e Pagave rezulton se Znj. {...} (Softa){...} ka ushtruar detyrën si Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në periudhën kohore 16.05.2000-01.04.2010. Sa më sipër, në bazë të verifikimeve të kryera në Sistemin CCMIS, nga Zyra e Arkivës dhe Zyrës së Financës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, lidhur me periudhën e referuar nga ana juaj, si evidenca

për përvojën profesionale të Gjyqtarës {...}, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, bashkëlidhur kësaj shkrese gjeni:

1. Kopje të Urdhrave të Brendshëm të Kryetarit të Gjykatës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

për periudhën 2000-2010;

- vendim datë 15.07.2008; vendim nr. 4420 akti datë 18.12.2008; vendim nr. 4443 akti datë 18.12.2008; vendim nr. 1530 akti datë 20.11.2008 “Mbi kërkesën e gjyqtarës për heqje dore nga gjykimi.”, Urdhër nr. 1 prot., datë 05.11.2009; Urdhër nr. 8 prot., datë 03.02.2009 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve për gjykimin e kërkesa ve të palëve, gjatë fazës së hetimeve paraprake”, Urdhër nr. 5 prot., datë 20.01.2009 “Mbi shpërndarjen e gjyqtarëve në dhoma, seksione e trupa gjykues, si dhe procedurat e ndarjes së çështjeve me short”(dhoma civile), Urdhër nr. 4 prot., datë 12.01.2009 “Mbi zhvillimin e gjykimeve penale e civile në salla gjykimi.”, Urdhër nr. 29 prot., datë 07.09.2009; Urdhër nr. 32 prot., datë 01.10.2009; Urdhër nr. 37 prot., datë 25.11.2009 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve për gjykimin e kërkesa ve të palëve, gjatë fazës së hetimeve paraprake”, vendim nr. 4202 akti datë 16.12.2008 “Mbi kërkesën e gjyqtarës për heqje dore nga gjykimi.”, Urdhër nr. 1 prot., datë 04.01.2006 “Mbi shpërndarjen e gjyqtarëve në dhoma, seksione e trupa gjykues, si dhe procedurat e ndarjes së çështjeve me short”(dhoma civile e përgjithshme), Urdhër nr. 10 prot., datë 03.02.2006 ; Urdhër nr. 28 prot., datë 15.05.2006; Urdhër nr. 42 prot., datë 30.10.2006; Urdhër nr. 20 prot., datë 15.10.2007 ; Urdhër nr. 25 prot., datë 05.09.2007; Urdhër nr. 5 prot., datë 20.04.2007; Urdhër nr. 20 prot., datë 12.05.2008; Urdhër nr. 11 prot., datë 21.03.2008 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve për gjykimin e kërkesa ve të palëve, gjatë fazës së hetimeve paraprake”, vendim datë 10.06.2008; vendim nr. 3076 akti datë 15.09.2008; vendim datë 06.10.2008 “Mbi kërkesën e gjyqtarës për heqje dore nga gjykimi.”, Urdhër nr. 19 prot., datë 12.05.2008 “ Për një ndryshim në urdhërin nr. 1 prot., datë 07/01/2008, “Mbi shpërndarjen e gjyqtarëve në dhoma, seksione e trupa gjykues”. Urdhër nr. 1 prot., datë 07.01.2008 “Mbi shpërndarjen e gjyqtarëve në dhoma, seksione e trupa gjykues”(dhoma tregtare).

2. Tabelë statistikore për periudhën e përvojës profesionale, e cila përmban numrin e vendimit, datën e vendimit, objektin e çështjeve në të cilat Gjyqtare {...} ka qenë trup gjykues. (rezulton të ketë trajtuar 937 çështje)

24. Vlen të theksohet se përsa i përket kriterit nën kriterit të “përvojës specifike profesionale” të kandidatës në fushën e të drejtës administrative, është e qartë përvoja e saj në këtë fushë të së drejtës si gjyqtare e Gjykatës së Apelit Administrativ.

25. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr.535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, ka mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës administrative, si dhe në fushën e të drejtës civile, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike profesionale minimale”.

26. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

27. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Lartë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, , të Vendimeve të Këshillit nr.535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”*.

28. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 13.12.2021, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk kam masë disiplinore në fuqi”*.

29. Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

30. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

31. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

32. Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Lartë, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr.535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”*. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”*. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëria ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”*.

33. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 13.12.2021, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

34. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë.

35. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, duke plotësuar kështu kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

III. KONKLUZIONE

38. Referuar kërkesave të Vendimit 75/2019, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimeve nr. 535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit të znj. {...}, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

39. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit për kandidaten znj. {...}, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi në lidhje me këto kriterë. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, të tre kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit dhe vijim e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si dhe në pikën 9, të vendimit të tij nr.535, datë 17.11.2021 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative” dhe vendimeve nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 535, nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR